

RAPORT PËRMbledhës

**MBI MONITORIMIN E RESPEKTIMIT TË
TË DREJTAVE THEMELORE TË
INDIVIDËVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË
INSTITUCIONET E SISTEMIT
PENITENCIAR
(2022 –2024)**



Ky raport u përgatit nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të mbështetjes institucionale të ofruar nga Fondacioni Sigrid Rausting Trust. Monitorimet mbi respektimin e nenit 8, u realizuan në kuadër të nismës “Jo Korrupsionit, Po Demokracisë”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe ekspertëve vëzhgues dhe hartues që kanë kontribuar në përgatitjen e tij.

Ekspertët vëzhgues (sipas rendit alfabetik):

Znj. Anada Farruku
 Znj. Ardita Kolmarku
 Znj. Ardita Matlija
 Z. Besim Ymaj
 Znj. Edlira Bylo
 Z. Emanuel Xhindi
 Z. Erdion Maçolli
 Znj. Eriselda Ndreca
 Z. Ernest Delia
 Z. Jorgen Kosta
 Znj. Laureta Roshi
 Z. Mario Prendi
 Z. Nikolin Muçaj
 Znj. Nosiana Burnazi
 Znj. Rabie Zika
 Z. Rigels Murataj
 Znj. Senada Aliu
 Znj. Teuta Pataj
 Z. Ymer Leksi
 Z. Zylyftar Bregu

Ekspertët hartues (sipas rendit alfabetik):

Znj. Elsa Toska, Eksperte e jashtme, KShH

Rishikim cilësor:

Znj. Nosiana Burnazi, Asistente Projektesh/ Paraligjore, KShH
 Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
 Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania Kutia Postare nr.1752

Mob: 0694075732

Web site: www.ahc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME	3
1. HYRJE.....	4
2. METODOLOGJIA.....	5
3. GJETJET KRYESORE.....	7
3.1. NDALIMI I TORTURËS DHE TRAJTIMIT ÇNJERËZOR	7
3.2. E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR FIZIK DHE MENDOR	7
3.3. E DREJTA PËR TË MBAJTUR LIDHJE ME FAMILJEN DHE KORRESPONDENCA	9
3.4. E DREJTA PËR ARSIM DHE PUNËSIM.....	10
3.5. KUSHTET INFRASTRUKTURE NË BURGJE DHE HAPËSIRAT PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE RE-KREATIVE	12
3.6. ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT NGA SEKTORI PSIKOSOCIAL DHE ZBATIMI I PROGRAMEVE TË REHABILITIMIT SOCIAL	14
3.7. PROCESI I RREGULLT LIGJOR NË VENDIMET PËR DHËNIEN E MASAVE DISIPLINORE	14
3.8. RESPEKTIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	16
3.9. ÇËSHTJE TË TJERA.....	16
4. QASJA INSTITUCIONALE NDAJ REKOMANDIMEVE TË KShH	17

SHKURTIME

DPB - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IEVP - Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

KEDNJ - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KL GJ - Këshilli i Lartë Gjyqësor

KPT - Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues

KShH – Komiteti Shqiptar i Helsinkit

MAS - Ministria e Arsimit dhe Sportit

MD - Ministria e Drejtësisë

MEKI - Ministria e Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit

MSHMS - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

OSHC - Organizatat e Shoqërisë Civile

Ligji nr. 81/2020 - Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve”

1. HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) parashikojnë detyrimin e organeve publike të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Përveç se në nivel kushtetues dhe konventor, edhe në nivel ligjor këto të drejta janë të parashikuara në mënyrë specifike dhe konkrete, duke ofruar garanci për individët. Ligji nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” reflekton këto standarde ndërkombëtare, duke u bërë një instrument i rëndësishëm ligjor në nivel kombëtar për të gjithë subjektet, si autoritetet publike dhe individët e privuar nga liria në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Personat e privuar nga liria, ashtu si çdo individ gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore edhe pse me status të posaçëm që i vjen për shkak të kufizimit të lirisë. Administrata publike në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ka detyrimin që të respektojë të drejtat kushtetuese të individëve me liri të kufizuar dhe vetëm në rast nevojë të justifikuar në ligj, të ndërhyjë proporcionalisht në të drejtat dhe liritë e tyre.

Në përputhje me misionin e tij, KShH prej vitesh ka ofruar kontributin modest me aktivitete monitoruese, trajnuese dhe shërbime ligjore falas për shtetasit e privuar nga liria në sistemin e burgjeve, duke patur si qëllim një nivel më të mirë respektimi dhe garantimi të të drejtave të këtyre shtetasve. Bazuar në konkluzionet e arritura nga kjo veprimtari, KShH ka ofruar gjithashtu kontribut modest në përmirësimin e legjislacionit parësor dhe dytësor të sistemit penitenciar, ku një pjesë e rekomandimeve tona rezulton se janë pasqyruar në këto akte. Është pozitiv fakti se KShH ka një marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi konstruktiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si institucioni epror i menaxhimit të sistemit të burgjeve si dhe me Ministrinë e Drejtësisë, që ka në varësi institucionet e sistemit penitenciar.

Gjatë periudhës Maj 2022 – Dhjetor 2024, KShH ndërmorri disa misione monitorimi, duke u fokusuar në situatën reale të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Mbi bazën e gjetjeve nga monitorimet është hartuar ky raport përmbledhës që së bashku me rekomandimet e paraqitura nga KShH dhe adresimit të tyre nga IEVP-të, mendojmë se mund t’i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm dhe forcimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve të privuar nga liria.

2. METODOLOGJIA

Raporti përmbledhës fokusohet në: (i) të dhënat e reflektuara nga të dhënat për rehabilitimin në burgje, në kuadër të monitorimeve të zhvilluara gjatë periudhës Korrik 2022 - Qershor 2023; (ii) të dhënat e reflektuara nga raportet e monitorimit dhe përgjigjet zyrtare të IEVP –ve të monitoruara mbi respektimin e nenit 8 të KEDNJ-së (të drejtës për një jetë private dhe familjare), gjatë muajve Maj-Qershor 2024; (iii) të dhënat e reflektuara nga raportet e monitorimit dhe përgjigjet zyrtare të IEVP-ve të monitoruara mbi respektimin e nenit 3 të KEDNJ, si dhe procesit të rehabilitimit dhe riintegritimit përgjatë vitit 2024.

Si për çdo monitorim, një ekip vëzhguesish të KShH-së u angazhuan për të monitoruar respektimin e të drejtave të shtetasve të dënuar dhe të paraburgosur në këto institucione. Metodologjia e ndjekur për këto monitorime përfshiu takimet me stafin e institucioneve, intervistat me shtetasit e burgosur dhe të paraburgosur, kqyrjen vizuale të ambienteve ku këta shtetas janë të akomoduar si dhe verifikimet në dokumentacionin e administruar në institucione.

Të dhënat e mbledhura janë analizuar më pas për të përpiluar këtë raport përmbledhës që vlerëson:

- a) respektimin e trajtimit dinjitoz me komponentët: (i) mosushtrimi i torturës; (ii) rehabilitimi; (iii) riintegrimi; (iv) kushtet e jetesës dhe ato infrastrukturore;
- b) respektimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor, mendor dhe fizik;
- c) respektimin dhe ofrimin e së drejtës për arsim dhe punësim në kuadër të rehabilitimit dhe riintegritimit;
- d) respektimin, realizimin dhe mbrojtjen e ofruar për të drejtën për jetë private dhe familjare, sipas komponentëve përbërës: (i) jeta private, (ii) familja, (iii) vendbanimi dhe (iv) korrespondenca dhe të dhënat personale, (iv) integritetin moral, fizik dhe psikologjik, si dhe (v) çështjet e identitetit dhe autonomisë personale të personave të burgosur;
- e) respektimin, realizimin dhe mbrojtjen e një procesi të rregullt ligjor, si e drejtë procedurale në funksion të të drejtave substanciale kushtetuese dhe ligjore të të paraburgosurve/dënuarve.

Më konkretisht, në këtë raport theksohet rëndësia e:

- Trajtimin njerëzor, si e drejtë themelore e njeriut dhe që gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ndërkombëtare. Kjo e drejtë është absolute nga natyra, që do të thotë se nuk mund të kufizohet. Kështu, tortura është konsideruar cenim i integritetit fizik dhe psikologjik të individit. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka theksuar se jo vetëm tortura, por në raste të veçanta edhe kushtet në të cilat mbahet një shtetas i burgosur apo i paraburgosur (përfshirë mbipopullimin) çojnë në trajtim degradues. Po ashtu, kushtet johigjenike, mungesa e aktiviteteve, dhe mosdhënia e mundësive të punësimit kanë qenë kritere mbi të cilat GJEDNJ-ja ka zhvilluar

jurisprudencën e saj duke vendosur se ka pasur shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, (trajtimi degradues dhe çnjerëzor).¹

- Jetës private të personave të privuar nga liria në burgje si thelbësore për ruajtjen e (1) integritetit moral, fizik dhe psikologjik (*trajtimi i duhur mjekësor, hapësira e përshtatshme e jetesës dhe higjiena*), (2) për garantimin e privatësisë së tyre (*mbrojtja e imazhit të tyre, konfidencialiteti, e drejta për t'u informuar, mbrojtja e të dhënave personale/mjekësore*); (3) mbrojtjen e identitetit dhe autonomisë personale të këtyre personave (*zhvillimi profesional, mbajtja e kontakteve me të tjerët dhe botën e jashtme*). Mbrojtja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale duhet të jetë proporcionale në raport me qëllimin e përdorimit, dhe të garantojë mbrojtjen nga abuzimi, sidomos për të dhënat personale si: gjinia, statusi martesor dhe informacioni mjekësor. Në asnjë rast nuk duhet të shpërndahen informacione që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të shtetasve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial. Siç dhe GJEDNJ-ja ka elaboruar në praktikën e saj gjyqësore, papërshtatshmëria e mjediseve të qëndrimit mund të shkaktojë cenim të dinjitetit njerëzor, sigurisë si dhe të privatësisë.²

- Jetës familjare, që përfshin të drejtën e të burgosurve për të mbajtur kontakte me anëtarët e ngushtë të familjes, nëpërmjet vizitave familjare. Sikundër dhe GJEDNJ-ja ka theksuar, çdo lloj vendimmarrje e autoriteteve të IEVP-ve do duhet të mbajë në konsideratë edhe interesat e të dënuarit si dhe lidhjet sociale dhe familjare të të dënuarve.³

- Korrespondencës së të dënuarve dhe të paraburgosurve (*me avokatin, familjarët apo dhe me institucionet e tjera shtetërore apo organizata të shoqërisë civile*), e cila mund të kufizohet vetëm duke ndjekur një qëllim legjitim dhe duke garantuar masa mbrojtëse për ta.

- Vendbanimit të tyre, që i referohet hapësirës jetike së tyre në qeli, e cila duhet të mbrohet nga ndotja, shqetësimet dhe zhurmat.

Ky raport përmbledhës reflekton situatën edhe në aspektin krahasues në raport me gjetjet nga monitorimet e mëparshme, si dhe situatën aktuale në raport me vazhdimësinë e ndjekjes së rekomandimeve nga IEVP-të e monitoruara. Raporti evidenton IEVP-të, të cilat në disa aspekte të respektimit të të drejtave të shtetasve të privuar nga liria kanë avancuar dhe janë përmirësuar, ashtu si dhe IEVP-të, të cilat kanë nevojë për të shtuar përpjekjet në drejtime konkrete të aspekteve të përmirësimit të të drejtave themelore të këtyre shtetasve.

Nga monitorimet kanë rezultuar edhe raste të nevojave për marrje masash urgjente për raste individuale, por edhe problematika strukturale në nivel insitucioni/esh. *Rekomandimet individuale* lidhen me iniciimin dhe verifikimin e rasteve konkrete nga KShH, ndërsa, *rekomandimet strukturale* i referohen rekomandimit për marrjen e masave në nivel të disa IEVP-ve, ose në nivel

¹ Vendimi Mandic dhe Jovic kundër Sllovenisë, 20 Tetor 2011, dhe Serce kundër Rumanisë, 30 Qershor 2015.

² Vendimi Varga dhe të tjerë kundër Hungarisë, 10 Mars 2015.

³ Vendimi Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rusisë, 25 Korrik 2013.

IEVP-je në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse. Për rrjedhojë, raporti reflekton dhe dy lloj qasjesh të KShH-së, nisur nga natyra e rekomandimeve si *individuale*, (referuar një çështjeje konkrete brenda një IEVP-je, ose një IEVP-je specifike) dhe *strukturele* (disa IEVP, ose të gjitha IEVP-të e monitoruara së bashku me insitucione të tjera përgjegjëse).

3. GJETJET KRYESORE

3.1. NDALIMI I TORTURËS DHE TRAJTIMIT ÇNJERËZOR

Në aspektin e ushtrimit të dhunës/torturës, nga monitorimet e periudhës Korrik 2022 - Qershor 2023, nuk rezultuan situata shqetësuese, por monitorimet e mëvonshme përgjatë vitit 2024, rezultuan me dy raste ankimi të të dënuarve, të verifikuara dhe të analizuara nga KShH në drejtim të dhunës së ushtruar nga stafi i IEVP-ve (Peqin dhe Shkodër).

Në IEVP Peqin, ndaj shtetasit J.M., (dhe disa të dënuarve të tjerë) që ekzekutonin dënimin në këtë institucion, është ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike nga forcat e DAP-it. Edhe në IEVP Shkodër rezultoi se një i dënuar i cili vuante nga çrregullime psikotike, (E.P.), u konfliktua me dy prej infermierëve të institucionit, pasi kërkonte t'i jepeshin doza më të mëdha medikamenti. Përdorimi i dhunës u konfirmua dhe mbas njohjes me kamerat e sigurisë, ku vërehej jo vetëm tërheqja zvarrë e të dënuarit, por dhe përdorimi i forcës gjatë tërheqjes së flokëve nga ambientet e observimit tek ato të izolimit.

Përdorimi i forcës fizike ndaj të burgosurve nuk lejohet, me përjashtim të rasteve kur është i nevojshëm për vetëmbrojtje, për të ndaluar aktet e dhunshme, sulmin fizik ndaj një të burgosuri tjetër, tentativat e largimit nga institucioni, vetëdëmtimin ose në rast të rezistencës aktive ose pasive ndaj një urdhëri të ligjshëm. Për rrjedhojë, KShH sugjeroi që në të ardhmen, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm përdorimi i forcës duhen zbatuar me rigorozitet parashikimet e neneve 70 e 71 të ligjit nr. 81/2020 e nenit 96 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

Në raste të caktuara edhe mbipopullimi apo mënyra se si flenë të dënuarit për shkak të tij mund të çojë në trajtim ç'njerëzor. Gjatë monitorimit të IEVP Fier nga verifikimi në terren i një prej dhomave të ambienteve të paraburgimit ishin të akomoduar tre persona, ndërkohë që ajo ishte e projektuar për të akomoduar dy persona, pasi përbëhej nga dy krevate, ndërsa një prej të akomoduarve flinte në dyshek në dysHEME.

3.2. E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR FIZIK DHE MENDOR

Sipas Kushtetutës, shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti (*neni 55/1*). Kujdesi mjekësor duhet të garantojë dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh kërkesat praktike të institucioneve të mbyllura, në përputhje me nenet 41 dhe 42 të ligjit nr. 81/2020. Garantimi i jetës në këtë vështrim nënkupton të drejtën për të kërkuar trajtim mjekësor

të specializuar jashtë institucionit ku qëndrojnë, si dhe shmangien e trajtimit mjekësor të detyrueshëm⁴ (i cili mund të justifikohet vetëm nëse kryhet për të mbrojtur shëndetin e individit).

Nga monitorimet përgjatë vitit 2024, kanë rezultuar mangësi në stafin mjekësor në disa IEVP, që ndikon drejtpërdrejt në dhënien e shërbimit mjekësor të nevojshëm si dhe në cilësinë e tij. Kështu, në IEVP Fushë-Krujë, shërbimi shëndetësor i ofruar nga mjeku me kohë të pjesshme nuk ishte i përshtatshëm dhe i vazhdueshëm për shtetasit e privuar nga liria. Në IEVP Peqin, ishin të emëruar vetëm 2 mjekë, të cilët angazhoheshin me kohë të pjesshme, ndërsa në organikë parashikoheshin 3 mjekë me kohë të plotë. Në IEVP Durrës, ishte i angazhuar vetëm një mjek psikiatër me kohë të pjesshme, ndërkohë që ishin 76 shtetas të akomoduar, të cilët vuanin nga probleme të shëndetit mendor.

Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë mungesën e interesit nga profesionistët për të kontribuar në sistemin mjekësor të sistemit të burgjeve, KShH ka ritheksuar rekomandimin e vazhdueshëm të adresuar ndaj MD-së dhe MSHMS-së, për marrjen e masave konkrete në zhvillimin e politikave për promovimin në karrierë të stafit ekzistues mjekësor, angazhimin nëpërmjet praktikave profesionale/stazhit të studentëve të mjekësisë, si dhe rishikimin sistematik të nivelit të pagave për këtë sektor në raport me vështirësinë.

Po në respektim të së drejtës për kujdes shëndetësor, KShH ka konstatuar dhe problematika infrastrukture mjekësore. Në IEVP Durrës, Burrel, Tepelenë rezultoi se transportimi i shtetasve për përfitimin e shërbimit shëndetësor realizohej me automjetet e policisë, për shkak të mungesës së një ambulance. Duke marrë në konsideratë që automjetet e policisë në të shumtën e kohës janë të angazhuara në transportimin e shtetasve në seancat gjyqësore si dhe ato nuk kanë infrastrukturën e nevojshme mjekësore si autoambulancat, KShH vlerësoi se cenohet e drejta e shtetasve për t'u transportuar sa më shpejt dhe konform protokolleve mjekësore, në spital në rastet e emergjencave mjekësore. KShH i rekomandoi Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrjen e masave për pajisjen e IEVP-ve me mjetet e autoambulancës. Në lidhje me këtë rekomandim nuk ka informacion të mëtejshëm.

Në aspektin e mangësive infrastrukture, KShH ka konstatuar problematika lidhur me mosakomodimin e arsyeshëm të personave me aftësi të kufizuara, sikurse në IEVP Tepelenë, ku disa të burgosur me aftësi të kufizuara fizike ishin vendosur në kushte të papërshtatshme infrastrukture⁵. Referuar pikës 1, të nenit 33 të ligjit 81/2020, si dhe me nenit 17 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, ku parashikohet që gjendja shëndetësore dhe nevojat mjekësore të individëve duhet të merren parasysh gjatë sistemimit, KShH rekomandoi marrjen e masave të menjëhershme për mundësimin e një mjedisi tjetër të përshtatshëm qëndrimi.

⁴ Shembuj të trajtimeve mjekësore të detyrueshme përfshijnë: analizat e gjakut dhe urinës, vaksinimet, trajtimin dentar, testet e tuberkulozit dhe administrimin e ushqimit.

⁵ Rasti i shtetasit A.LL i cili ishte akomoduar në katin e dytë të institucionit, megjithëse kishte një gjymtyrë të amputuar dhe lëvizte me paterica. Lidhur me rastin konkret, KShH nuk ka informacion nëse rekomandimi për akomodim të arsyeshëm është plotësuar.

KShH ka konstatuar problematika edhe në drejtim të respektimit të nenit 13 dhe 14 të ligjit nr. 81/2020, me qëllim garantimin e trajtimit të individualizuar e të përshtatshëm për trajtimin shëndetësor për shtetasit e akomoduar në këto institucione. Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale në mënyrë formale, cenon procesin e rehabilitimit dhe rinteprimit, veçanërisht të një kategorie vulnerabël në sistemin e burgjeve, sikurse janë shtetasit me probleme të shëndetit mendor. Konkretisht në IEVP Tepelenë me rastin e shtetasit D.H., i cili vuante nga probleme të shëndetit mendor, u konstatua se megjithëse ishte hartuar një plan trajtimi, vlerësimi i ecures së tij mungonte. Edhe në lidhje me këtë rekomandim nuk ka informacion të mëtjetshëm. Po në këtë IEVP, u evidentua si problem menaxhimi jo i duhur i gjendjes emocionale të shtetasve me tendencë vetëvrasjeje.⁶ Situata bëhej veçanërisht e vështirë për faktin se institucioni dhe pse formalisht kishte një psikolog të komanduar, efektivisht nuk kishte një psikolog që të ushtronte detyrën. KShH duke vlerësuar se roli i psikologut dhe punonjësve socialë është thelbësor për menaxhimin e gjendjes emocionale dhe procesin e rehabilitimit dhe riinteprimit të personave të paraburgosur, i ka sugjeruar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve krijimin e urave të bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut si dhe Urdhrin e Punonjësve Socialë për të mundësuar trajtimin efektiv psiko-social të këtyre shtetasve.

Po në kuadër të së drejtës për kujdes shëndetësor, KShH evidenton dhe disa problematika të tjera të lidhura me cilësinë e ushqimit (IEVP Fushë-Krujë dhe Peqin), dieta ushqimore të papersonalizuara sipas nevojave të të sëmurëve me diabet (IEVP Shkodër), mostrajtim i të sëmurëve me shërbimin stomatologjik shtetëror, por në klinika private (IEVP Burrel), mospasja e ambienteve të përshtatshme për duhanpirësit, të cilët konsumonin lirisht duhanin në ambientet e brendshme, ndërkohë që kishte të dënuar, që për arsye shëndetësore (azmatikë) mund të dëmtoheshin nga ky ambient (IEVP Rrogozhinë).

3.3. E DREJTA PËR TË MBAJTUR LIDHJE ME FAMILJEN DHE KORRESPONDENCA

E drejta për jetën familjare nënkupton mbajtjen e kontakteve midis personave të privuar nga liria dhe familjarëve të tyre, ndër të tjerash, nëpërmjet vizitave. Autoritetet shtetërore mund të kufizojnë kryerjen e këtyre vizitave vetëm në mënyrë proporcionale, në raste të veçanta, të mbështetura në ligjin nr. 81/2020 si dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Respektimi i kësaj të drejte ndikon në procesin e rehabilitimit dhe riinteprimit. Kjo kërkesë është e rëndësishme veçanërisht për personat e burgosur me masa të larta dënimi.⁷

E drejta e shtetasve të privuar nga liria për zhvillimin e vizitave dhe mbajtjen e lidhjeve me familjen, si dhe e drejta e mbajtjes së korrespondencës në përgjithësi ka funksionuar normalisht pranë institucioneve të monitoruara. Nga monitorimet e periudhës Maj 2022- Qershor 2023 ka rezultuar se në disa prej IEVP-ve të monitoruara nuk respektohej kohëzgjatja prej 1 ore e takimeve

⁶ Në IEVP Tepelenë ka 15 shtetas me sëmundje kronike, nga të cilët 3 shtetas me probleme të shëndetit mendor. Disa prej tyre kishin diagnoza të shumëfishta dhe kërkonin ndjekje të specializuar.

⁷Vendimet “Khoroshenko kundër Rusisë”; “Piechoëicz kundër Polonisë” dhe “Danilevich kundër Rusisë”.

online, në rastet kur zëvendësoheshin me ato fizike. (Kështu, kohëzgjatja e takimeve online varionte: I EVP Burrel 15-30 minuta; I EVP Tepelenë, Peqin, Fier, Kavajë 30 minuta; I EVP Lushnjë 15 minuta).

Pavarësisht, përmirësimeve në këtë drejtim, krahasuar me gjetjet nga monitorimet e mëparshme, edhe nga monitorimet përgjatë vitit 2024, rezultuan disa problematika në të paktën dy I EVP. (I EVP Fushë -Krujë mundësonte 15 minuta të bisedave në Skype, ndërsa I EVP Tepelenë rezultonte në pamundësi ofrimi të mundësisë për takimet online, për shkak të kompjuterave jashtë funksionit).

Në drejtim të cilësisë së mbajtjes së marrëdhënieve me familjen, KShH ka konstatuar se prej muajit shtator 2024, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka urdhëruar ndërprerjen e përdorimit të programeve Skype ose MSN, dhe përdorimin tashmë të programit Microsoft Teams. Për shkak të vështirësive në përdorimin e kësaj platforme të re, nga kqyrja e Librave të regjistrimit të takimeve të bisedave Skype me familjarët në disa prej I EVP-ve të monitoruara, fillimisht është konstatuar ulje e ndjeshme e numrit të personave të akomoduar që zhvillonin këto takime online. KShH duke marrë në konsideratë vështirësinë me mbajtjen e komunikimeve përmes kësaj platforme, i sugjeroi DPB-së gjetjen e mënyrave të tjera alternative për të ruajtur sigurinë e institucioneve, por edhe për të respektuar të drejtën e shtetasve për një jetë private dhe familjare në përputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në I EVP Fier, kishte vonesa në regjistrimin e numrave me të cilët të dënuarit kërkonin të zhvillonin biseda telefonike, duke krijuar vështirësi në mbajtjen e kontakteve me familjarët. Ndërsa, në I EVP Rrogozhinë, u konstatuan ambiente të papërshtatshme familjare, ndaj dhe u rekomandua marrja e masave për rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.

KShH vlerëson se moskrijimi i kushteve të nevojshme për realizimin e takimeve online, moszhvillimi i bisedave telefonike cenon të drejtën e shtetasve të privuar nga liria për ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve familjare. KShH rekomandon marrjen e masave për sigurimin e takimeve online në një kohëzgjatje prej 1 ore, sikurse parashikohet për takimet fizike, në përputhje me parashikimet e nenit 70 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

3.4. E DREJTA PËR ARSIM DHE PUNËSIM

Ligji nr. 81/2020, në nenin 45 të tij parashikon se arsimimi dhe formimi kulturor e profesional realizohen me anë të organizimit të programeve arsimore, si dhe të kurseve profesionale, sipas legjislationit në fuqi dhe personat e burgosur kanë të drejtën e përfundimit të arsimit nëntëvjeçar apo të atij të mesëm. Ofrimi i kushteve dhe mundësive për ndjekjen e arsimit përbën një element shumë të rëndësishëm në funksion të rehabilitimit dhe riintegrit të këtyre personave në shoqëri. KShH ka evidentuar praktika të ndryshme të ndjekura pranë I EVP-ve të monitoruara dhe nivele të ndryshme të realizimit të kësaj të drejte.

Nga monitorimet përgjatë vitit 2024, ka rezultuar se në I EVP Fushë – Krujë, përveç kurseve të formimit profesional për gjuhët e huaja dhe kujdestari sociale, mungonin kurset artizanale, të cilat

janë të nevojshëm për edukimin dhe përfitim të një profesioni të çertifikuar. Disa prej shtetasve të dënuar, siç rezultoi nga vëzhgimi i punimeve në muret e institucionit kanë treguar prirje artistike të tilla, që mund të jenë pjesë e aktiviteteve të ndryshme. KShH sugjeroi që në bashkërendim me Zyrat Rajonale të Punës, të mundësohet zhvillimi i kurseve të formimit profesional për punimet e drurit, metalit, hidraulik, elektrikist/instalime elektrike, mekanik, etj, të cilat si rregull zhvillohen pranë zyrave të punësimit. Në IEVP Tepelenë dhe në IEVP Lushnjë nuk organizoheshin kurse të formimit profesional dhe arsimor të detyrueshëm. Mungesa e kurseve të formimit profesional u konstatua edhe në IEVP Shkodër dhe IM Kavajë (në këtë të fundit u konstatua mungesa e një mësuesi fillor dhe mësuesi specialist për zhvillimin e kursit të punës me dru). Po ashtu në IEVP Fier nuk po zhvillohej asnjë program mësuesor apo kurs profesional, përveç gjuhës së huaj (anglisht).

Nga informacioni i ardhur nga DPB-ja rezulton se janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi mes këtij institucioni, Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, me qëllim arsimimin e shtetasve që ndodhen në IEVP. Po në kuadër të arsimit dhe të formimit profesional për personat e dënuar në institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale është hartuar udhëzimi i përbashkët mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Sa i përket formimit profesional, mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit Profesional është lidhur marrëveshja e datës 06.11.2024, me qëllim kryesor planifikimin dhe organizimin e kurseve profesionale për personat e dënuar në çdo IEVP, si dhe motivimin e të dënuarve përmes politikave incentivuese.⁸

Për sa më lart, pas vlerësimeve të KShH, se mungesa e programeve të tilla formuese, cenon procesin e rehabilitimit të shtetasve të dënuar, dhe rekomandimeve konkrete, konstatohet se hapi i parë përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit është hedhur nga institucionet. Megjithatë, problematike mbetet zbatimi i rregullt dhe sistematik në praktikë i këtyre marrëveshjeve, në disa raste edhe për shkak të mungesës së burimeve njerëzore. KShH vlerëson se duhet ndjekur në vazhdimësi ndërmarrja e veprimeve konkrete për ta bërë të realizueshëm procesin e rehabilitimit të të dënuarve në këtë aspekt.

3.5. KUSHTET INFRASTRUKTURE NË BURGJE DHE HAPËSIRAT PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE RE-KREATIVE

Në ndërtimin e IEVP-ve të reja, kryesisht ato të ndërtuara vitet e fundit, krahas garantimit të paramentrave të sigurisë, institucionet përgjegjëse janë kujdesur edhe për krijimin e ambienteve të përbashkëta, me fokus përdorimin e tyre për qëllime të organizimit të aktiviteteve psiko-sociale.

Disa prej institucioneve të monitoruara nga vëzhguesit e KShH-së gjatë periudhës Maj 2022-Qershor 2023 kanë pasur hapësira të mjaftueshme, të dedikuara dhe të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rekreative psiko-sociale apo për socializimin e personave të privuar nga liria. Të tilla

⁸ Referuar shkresës nr.1976/1, date 13.10.2024 të DPB, drejtuar KSHH.

janë ambientet për ushtrimin e besimit fetar, bibliotekat, si dhe klasat për zhvillimin e kurseve të ndryshme profesionale dhe arsimore apo për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve nga sektorët përkatës.⁹ Megjithatë, kushtet infrastrukturore në disa prej IEVP-ve janë konstatuar të amortizuara, me prezencë të shtuar të lagështisë dhe të papërshtatshme për akomodimin e shtetasve të privuar nga liria. Shtetasit e akomoduar kanë ngritur shqetësime mbi mungesën e programeve dhe aktiviteteve rekreative si dhe të ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e tyre, përfshirë dhe mjetet e nevojshme logjistike.¹⁰ Ndërkohë në IEVP të tjera, problematika lidhet me mungesën e hapësirave të dedikuara për përdorim nga punonjësit socialë dhe psikologë të sektorit të çështeve shoqërore.¹¹ KShH ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur përmirësimin dhe rikonstruksionin e ambienteve të banimit si dhe ato të ajrimit, si dhe për marrjen e masave konkrete nga IEVP-të.¹² Në vlerësimin e KShH-së mos garantimi i kushteve të tilla cenon në praktikë respektimin e dinjitetit njerëzor apo trajtimin njerëzor e human të shtetasve të privuar nga liria. Gjithashtu mungesa e mjediseve të posaçme për zhvillimin e takimeve midis shtetasve të akomoduar dhe punonjësve psiko-social të IEVP-ve vështirëson zbatimin e planeve individuale të trajtimit, në referim të parashikimeve të nenit 13 e 14 të ligjit nr. 81/2020.¹³

Ndërsa, referuar monitorimeve gjatë vitit 2024 u konstatuan pamjaftueshmëri si: mungesa e një fushe sportive dhe mungesa e pajisjeve në palestër (në IEVP Shkodër); mungesa e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e vizitave familjare gjatë ditëve me kushte klimaterike jo optimale (IEVP Rrogozhinë); mungesa e tendave mbrojtëse për rastet e kushteve të këqija atmosferike dhe e pajisjeve me të cilat mund të ushtrohej aktivitet fizik i përditshëm (IEVP Fier); mungesa e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve fizike dhe mungesa e televizorëve funksional në sallën e aktiviteteve (në IM Kavajë); mungesa e një klase për zhvillimin e takimeve me stafin ligjor dhe psikosocial (në IEVP-në Lushnjë); mungesa e hapësirave ku të zhvillohen aktivitete rekreative e sociale (IEVP Lezhë Shqetësuese janë amortizimet e godinave IEVP Tepelenë, Lushnjë dhe Lezhë), mungesa e dusheve, kaldajës, mos izolimit të tarracës, (IEVP Fushë- Krujë), prezenca e tepërt e lagështisë, (në IEVP Fushë – Krujë, Burrel, Durrës, Tepelenë, Lushnjë, Lezhë); mbipopullimi në sektorin e paraburgimit si dhe në dhomat e të dënuarve, (IEVP

⁹ IEVP Fier, IEVP Reç.

¹⁰ Pranë IEVP Peqin është konstatuar mungesë e hapësirës, e tavolinave dhe karrigeve në klasat mësimore në referim të numrit të nxënësve të regjistruar.

Në IEVP Korçë është konstatuar mungesë e ambienteve të ndara për ushtrimin e riteve fetare, si dhe mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm në vazhdimësi.

¹¹ Në IEVP Burrel dhe IEVP Lushnjë, mungojnë klasat e dedikuara për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale apo për zhvillimin e takimeve me shtetasit e burgosur nga stafi përkatës.

¹² Përmes shkresës nr. 639 prot., datë 25.11.2022; shkresës nr. 642 prot., datë 25.11.2022, KShH i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe Ministrisë së Drejtësisë zgjidhjen funksionale të kësaj problematike me qëllim që personat e akomoduar të trajtohen në përputhje me standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

¹³ Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale, psikologjike, shoqërore, gjinore, të moshës, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i burgosuri, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.

Peqin, Lezhë, Fier)¹⁴; tualetet dhe dushet të përbashkëta, në të gjitha ambientet e sigurisë së lartë, kur kishte mundësi për t'i pasur të ndara, (IEVP Burrel); mungesa e kushteve higjienike të tualeteve (IEVP Tepelenë, Durrës).

Veçanërisht sa i përket IEVP Tepelenë, gjatë monitorimit të kushteve infrastrukturore u konstatua se godina e këtij institucioni ishte tepër e amortizuar, jashtë standardeve minimale për jetesë. Edhe pse nga Komiteti për Prandalimin e Torturës (KPT), është sugjeruar mbyllja e këtij institucioni, gjithsesi deri në një vendimmarrje për mbyllje, nga KShH u sugjerua pas vizitës monitoruese marrja e masave të nevojshme për sensibilizimin dhe informimin e shtetasve të paraburgosur dhe pajisjen e tyre me të gjitha materialet e nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës personale, sipas parashikimeve të nenit 32 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Ndërsa, në IEVP Jordan Misja, edhe pas ndërhyrjeve të realizuara në infrastrukturë, pjesërisht pozitive si dhe sistemimi i kabinave të dushimit me pajisjet e domosdoshme, dhomat e akomodimit nuk kishin mjaftueshëm dritë natyrore të bollshme dhe njësi katrore të mjaftueshme jetese, sipas standardit për frymë të vendosur nga ligji.

Për sa më lart, të gjitha institucionet e monitoruara kanë problematika me standardet e duhura sa i përket infrastrukturës, për rrjedhojë ato kanë detyrimin për shtim të ambjentëve për të shmangur mbipopullimin, për të garantuar klasa sociale, ambiente recreative, biblioteka dhe ambiente sportive. Po ashtu ato kanë detyrimin e mirëmbajtjes së godinave ekzistuese, standard që duhet monitoruar në vazhdimësi për shkak të karakterit progresiv, i cili mund të jetë dinamik në kuptim të përmirësimit, ose përkeqësimit të kërkesave shëndetësore dhe higjienike të standardit minimal të jetesës.

3.6. ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT NGA SEKTORI PSIKOSOCIAL DHE ZBATIMI I PROGRAMEVE TË REHABILITIMIT SOCIAL

Në kuadër të përmbushjes së funksionit dhe qëllimit të dënimit penal, një nga elementët kryesorë të rehabilitimit social dhe riintegritimit lidhet pikërisht me zbatimin e planeve individuale të trajtimit të personave të privuar nga liria. Kreu III i ligjit nr. 81/2020 ka parashikuar rregullime të detajuara mbi trajtimin e këtyre personave, duke filluar që nga momenti i paraburgimit e më tej dhe pas lirimit nga institucioni.

Nga monitorimet e mëparshme të periudhës Maj 2022 - Qershor 2023, në përgjithësi dosjet psiko-sociale të personave të akomoduar kanë rezultuar të plotësuar, së bashku me dokumentacionet mbështetëse. Megjithatë, tërheq vëmendjen plotësimi i tyre me një gjuhë formale, narrative dhe pa shumë detaje në raport me personalitetin dhe nevojat e shtetasve të privuar nga liria. Në disa raste

¹⁴ Në IEVP Fier, pasi u konstatua problematikë me akomodimin në dhomë të një shtetasi (B.B. i akomoduar në sektorin e paraburgimit), u rekomandua marrja e masave të menjëhershme për garantimin e mjediseve që respektojnë dinjtetin njerëzor, privatësinë e kushtet higjienike për këtë të dënuar.

të marra në shqyrtim, seksionet e përmbledhjeve mujore kanë pasur përmbajtje mekanike të njëjta nga muaji në muaj.

Nga monitorimet përgjatë vitit 2024, rezultoi mungesë e një klasë e dedikuar për zhvillimin e takimeve nga ana e stafit ligjor dhe psikosocial me shtetasit e burgosur (IEVP Peqin), mospaisja e ambienteve të dedikuara me mjetet e nevojshme për funksionalitetin e tyre, ku vihej re mungesa e tavolinave të punës, raftëve, librave dhe mjeteve të tjera, (IEVP Fushë – Krujë); mungesë aktiviteteve sociale (IEVP Burrel)¹⁵.

3.7. PROCESI I RREGULLT LIGJOR NË VENDIMET PËR DHËNIEN E MASAVE DISIPLINORE

Procesi i rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, gjendet i reflektuar dhe në ligjin nr. 81/2020, perkatësisht në nenet 65-67 të tij. Konkretisht, çdo lloj procedure e dhënies së masave disiplinore nga Komisioni Disiplinor nuk inicihet dhe nuk përfundon me vendim për dhënien e masës disiplinore, pa dëgjuar më parë të burgosurin ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor. Është detyrë e institucionit të marrë masa për njoftimin e të dënuarit për fillimin e procedimit disiplinor. Barra e provës i takon institucionit, i cili duhet të vërtetojë se e ka njoftuar të dënuarin, edhe kur ky i fundit refuzon të ndjekë procedurën ligjore të vërtetimit të refuzimit (nënshkrimin e dy personave të tjerë nga personeli i institucionit, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shërbyer si shkak për fillimin e procedimit disiplinor).

Ligji sanksionon se masat disiplinore, përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë si dhe përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë, fillojnë efektin e tyre nga momenti i zbatimit, (neni 67, pika 4 e ligjit), ndërsa dy masat e tjera, të parashikuara, si këshillim individual si dhe përjashtim nga ajrosja në grup, (neni 64), fillojnë efektet nga momenti i marrjes së një vendimi nga komisioni disiplinor.

Ndaj të burgosurve me aftësi ndryshe fizike ose çrregullime të shëndetit mendor masat disiplinore, përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë si dhe përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë nuk mund të jepen nëse ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes së tyre, bazuar në raportin mjekësor. Masat disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta, nuk mund fillojnë të zbatohen pa pasur një raport paraprak të lëshuar nga mjeku, që vërteton gjendjen fizike dhe mendore të të burgosurit. Zbatimi i masës disiplinore të përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta i nënshtrohet kontrollit të përditshëm mjekësor. Gjatë zbatimit të kësaj mase

¹⁵ Midis Drejtorisë së IEVP Burrel dhe Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive kishte një komunikim zyrtar nëpërmjet shkresave. Në datën 16 shtator 2024, AKPA njofton IEVP Burrel se: “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) nga data 16.06.2024 për cdo aplikim në zhvillimin e kurseve profesionale të punëkërkuesve të papunë e të gjithë kategoritë e tjera pa përjashtim që kërkojnë këtë shërbim, aplikimi kryhet nëpërmjet sistemit e-albania”.

disiplinore duhet t'i garantohet të paktën një herë kontakte me anëtarët e familjes dhe të paktën një orë ajrim çdo ditë nëse e lejojnë kushtet atmosferike.

Nga monitorimet e mëparshme të periudhës Maj 2022- Qershor 2023, në kuadër të verifikimit të praktikës së zbatuar në dhënien e masave disiplinore, KShH ka evidentuar praktika të konsoliduara sa i takon dokumentave të hartuar në kuadër të procedurës ligjore përkatëse (IEVP Ali Demi), si dhe analiza logjike të vendimmarrjeve të Komisioneve të Vlerësimit të Masave Disiplinore. Megjithatë në disa prej rasteve të analizuara nuk rezultoi zbatimi paraprak i masave këshilluese apo ndërmjetësuese, bazuar në parashikimet e nenit 61 pika 1 të ligjit nr. 81/2020, si dhe ka pasur raste të konstatimit të mungesës së mjekut apo raportit shëndetësor të hartuar prej tij gjatë mbledhjeve të zhvilluara nga Komisioni Disiplinor.

KShH ka rekomanduar respektimin e standardeve ligjore mbi njoftimin e personit, njoftimin e akteve, përmes të cilave fillon procedura e dhënies së masave përkatëse, praktika që bien në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke cenuar kështu edhe të drejtën e ankimit të masës brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 67 të ligjit nr. 81/2020.

Ndërkohë, nga monitorimet përgjatë vitit 2024, situata duket më e përkeqësuar në disa elementë të procesit të rregullt ligjor. Janë konstatuar praktika të ndryshme në caktimin e masave disiplinore, pasi rezultoi se ato vendoseshin në ekzekutim menjëherë, pa pritur që të kalonte afati i ankimit në dispozicion të shtetasit të burgosur për të kundërshtuar masën, (IEVP Fushë – Krujë, Fier); mungesë e mjekut në mbledhjet e komisionit disiplinor, si dhe mungesë e administrimit të raportit mjekësor nga ana e komisionit, (IEVP Peqin); mungesë e nënshkrimit të anëtarëve të komisionit në urdhra për fillimin e procedurave disiplinore (IEVP Durrës, Tepelenë); mungesë e firmës së mjekut në urdhërin e Drejtorit për mbledhjen e Komisionit disiplinor, ndërkohë që i proceduari vuante nga probleme të shëndetit mendor (IEVP Fier); mungesa e një analize të detajuar nga ana e mjekut si dhe caktimi i masës më të rëndë disiplinore, duke dëmtuar rehabilitimin e shtetasve të dënuar, pa respektuar proporcionalitetin e dënimit (IEVP Fier); mungesë e raportit mjekësor të nevojshëm për të vlerësuar gjendjen shëndetësore para nisjes së procedimit disiplinor, (IEVP Tepelenë)¹⁶; mungesë njoftimi e të proceduarit, ndaj të cilit ka nisur procesi disiplinor (IEVP Burrel); mosunifikimi i praktikave të mbajtjes së dokumentacionit ndërmjet sektorëve si dhe regjistrimit të saktë të të dhënave, (IEVP Jordan Misja); mungesën e një përkthyesi të angazhuar, për të paraburgosurit e huaj (IEVP Jordan Misja).

Pjesëmarrja e mjekut në mbledhjet e komisionit disiplinor përbën një garanci thelbësore për vlerësimin e proporcionalitetit të kushteve të ekzekutimit të masës disiplinore nga i burgosuri në raport me gjendjen e tij shëndetësore, ndaj KShH vlerëson praktikën cilësore të mbajtjes së masave disiplinore dhe mbikëqyrjen e tyre nga mjeku në disa IEVP (IEVP Burrel dhe IEVP Jordan Misja). Po ashtu, arsyetimi i vendimeve dhe njoftimi për dhënien e masave disiplinore sipas kopjeve të

¹⁶ Praktika e dosjes së shtetasit Gj.L, urdhër datë 27.06.2024, si dhe e shtetasit A.D, urdhër datë 25.06.2024 dhe praktika e dosjes së shtetasit K.Q, A.A

njoftimit bashkëlidhur të marra në shqyrtim rezultonte si një praktikë e mirë administrative (IEVP Jordan Misja).¹⁷

3.8. RESPEKTIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Institucionet e mbyllura mbledhin, ruajnë dhe përdorin informacione personale për personat e akomoduar në to, në përputhje me nenin 35 dhe 36 të Kushtetutës, si dhe nenin 8 të KEDNJ-së. Mbajtja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave për një person duhet të jetë në mënyrë proporcionale dhe të garantojë mbrojtjen nga abuzimi, sidomos për të dhënat personale si: gjinia, statusi martesor dhe informacioni mjekësor. Në asnjë rast nuk duhet të shpërndahen informacione që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të shtetasve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial.

Nga monitorimet gjatë periudhës Maj 2022- Qershor 2023 rezulton se nuk ka pasur raste të keqadministrimit të të dhënave personale. Megjithatë, gjatë monitorimit përgjatë vitit 2024, të dënuarit në IEVP Burrel shprehën shqetësim se llogaritë bankare që ishin lidhur me Bankën BKT, ishin jo funksionale sepse kjo bankë nuk kishte degë në Burrel. Në këto kushte, për të “ndihmuar” këta të dënuar, kompania që ofron shërbimin tregtar online në burgje kishte hapur dhe administronte llogaritë e tyre bankare. Sipas stafit të IEVP-së shpenzimet dhe gjendja e mbetur bëhej kurdoherë transparente për personat e akomoduar. Në vlerësimin e KShH-së, kjo praktikë cenon privatësinë e të dënuarve, shqetësim ky që u pohua dhe nga vetë ata. KShH i sugjeroi DPB-së marrjen e masave me qëllim unifikimin e kësaj praktike, duke marrë në konsideratë edhe shqetësimet e shprehura nga personat e dënuar apo të paraburgosur.

3.9. ÇËSHTJE TË TJERA

Përgjatë misionëve të monitorimit, vëzhguesit e KShH-së kanë identifikuar edhe problematika të tjera, në drejtim të respektimit të të drejtave të shtetasve të privuar nga liria, të cilat vlen të përmenden në mënyrë të përmblodhur në vijimësi.

Kështu, në IEVP Burrel, rezultoi se çmimet e dyqanit të produkteve ishin shumë të shtrenjta dhe me luhatje të konsiderueshme brenda ditës. Në vijim, shqetësime u ngritën edhe për përmasat e lejuara të frigoriferëve që mund të blihen, pasi ato nuk ishin të unifikuara për të gjithë të dënuarit, duke krijuar kështu pabarazi e pakënaqësi mes tyre. KShH i sugjeroi Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrjen e masave me qëllim mbajtjen në mbikëqyrje të luhatjeve të çmimeve të produkteve bazë ushqimore, si dhe unifikimin e praktikës që zbatohet për blerjen e sendeve elektro-shtëpiake.

¹⁷ - Verifikimi i dosjes juridike të shtetasit me inicialet A.D, ndaj të cilit ishte aplikuar masë disiplinore për përjashtimin nga veprimtari e përbashkëta për 10 ditë.

- Verifikimi i dosjes juridike të shtetasit me inicialet M.B, ndaj të cilit ishte aplikuar masa disiplinore e përjashtimit nga ambientet e përbashkëta për një periudhë 6 ditore për shkak të një mosmarrëveshje që kishte patur në një tjetër të paraburgosur.

Në IEVP “Jordan Misja”, vëzhguesit u njohën me vonesat lidhur me zbardhjen e vendimeve të gjykatave, tej afateve ligjore për shtetasit e privuar nga liria. Në kushtet e miratimit të ligjit të fundvitit 2024 për Amnistinë Penale, këto vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore krijojnë edhe problematika në identifikimin e shtetasve që përfitojnë nga amnistia.

Në IEVP Durrës nuk mbahej në versionin elektronik, regjistri fizik i kërkesë-ankesave, në cenim të parashikimeve të ligjit nr. 81/2020. Në IEVP Lushnjë, tek libri i kërkesë-ankesave nuk rezultonte nënshkrimi i shtetasve të burgosur sipas kriterëve ligjore, ndaj u rekomandua respektimi i kësaj kërkesë të ligjit.

4. QASJA INSTITUCIONALE NDAJ REKOMANDIMEVE TË KShH

GjEDNJ-ja ka konsideruar se shtetet kanë detyrime pozitive sipas nenit 3 të KEDNJ-së që ndalon torturën dhe trajtimin ç’njerëzor, të cilat përfshijnë, *së pari*, një detyrim për të vendosur një kuadër legjislativ dhe rregullator të mbrojtjes; *së dyti*, në disa rrethana të mirëpërcaktuara, një detyrim për të marrë masa operacionale për të mbrojtur individë të caktuar nga rreziku i trajtimit në kundërshtim me këtë dispozitë; dhe *së treti*, një detyrim për të kryer një hetim efektiv për pretendimet e diskutueshme për shkaktrimin e një trajtimi të tillë¹⁸.

KShH, thekson se përgjegjësia e shtetit dhe angazhimi maksimal i institucioneve shtetërore të përfshira në këtë proces mbetet faktor kyç i realizimit të të drejtave themelore të njeriut dhe më specifikisht të të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve në kushtet e lirisë së kufizuar. Bashkëpunimi dhe koordinimi mes institucioneve duhet të jetë faktor kyç për përmirësimin e standardeve të jetës të shtetasve të dënuar. Në këtë drejtim, roli i DPB-së është tepër i rëndësishëm.

Fillimisht duhet theksuar se qasja proaktive e shumicës së institucioneve ndaj rekomandimeve të KShH është për t’u përshëndetur. Rekomandimet, duke u bazuar tek përgjigjet e institucioneve mund të ndahen në tre kategori si: (i) të plotësuara tërësisht; (ii) në proces realizimi dhe (iii) të paplotësuara. Sikundër evidentohet në raport, disa nga rekomandimet ishin të përsëritura, që do të thotë të parealizuara.

KShH vlerësoi se mbipopullimi në burgje është një fenomen i cili kërkon zgjidhje të qëndrueshme, e cila nuk varet nga një IEVP. Për rrjedhojë, edhe pse IEVP-të e Peqinit, Lezhës dhe Tepelenës e kishin shqetësim thelbësor mbipopullimin, KShH nuk vlerësoi relevante të japë rekomandime për institucionin e monitoruar. Kjo situatë kërkon koordinim dhe bashkëpunim mes DPB-së dhe MD-së, por njëkohësisht një politikë më pak të ashpër në kërkimin/caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” nga prokuroria/gjykata, duke ndihmuar në uljen e mbipopullimit në sektorin e paraburgimit.

¹⁸ Vendimi X dhe të tjerë kundër Bullgarisë, 2021, prg.178.

Në respektim të nenit 79 të ligjit nr. 81/2020, lidhur me zbardhjen e vendimeve gjyqësore për ata shtetas që kanë përfitur aministi penale, DPB-ja si dhe MD-ja, duhet të rrisin bashkëpunimin me organet e pushtetit gjyqësor dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), me qëllim nxitjen e një klime ndër-institucionale për përmbushjen në kohë të të drejtave të të burgosurve. Të vetëdijshëm për ngakesën e çështjeve me të cilën përballlet sistemi gjyqësor sot, sërish mund të zbatohen mekanizma nxitës, me qëllim respektimin e të drejtave themelore të këtyre shtetasve, duke shmangur vonesat e panevojshme, të cilat mund t'i çojnë ata në kufizim të paligjshëm të lirisë.

Për t'u përmendur pozitivisht, është trajtimi i rekomandimeve nga I EVP Lezhë, për marrjen e masave për krijimin e një hapësire të dedikuar për zhvillimin e programeve rehabilituese dhe riintegruese, përfshirë dhe lexim literature të shkruar. Në përgjigje të rekomandimit, I EVP Lezhë njoftoi se kanë proceduar me përshtatjen e një ambienti si mini-bibliotekë. I EVP Burrel kishte marrë gjithashtu masat për krijimin e një biblioteke.

Ajo që konstatohet në tërësi nga monitorimet e I EVP-ve, është se mungesa e stafit për formimin profesional dhe arsimor, si dhe mungesa e ambienteve për zhvillimin e aktiviteteve nuk krijojnë premisat për garantimin e integritetit dhe rehabilitimit të shtetasve të akomoduar në këto institucione. Kjo do të ndihmonte që këta shtetas gjatë shlyerjes së dënimit të kenë mundësinë të formohen si individë me kulturën e punës dhe me një profesion të certifikuar.

Po ashtu, e drejta për kujdes shëndetësor e cila ndërthuret edhe me trajtimin dinjitoz e human, mbetet sfiduese për shtetasit e privuar nga liria në sistemin penitenciar, pasi kryesisht mungesat e konstatuara në infrastrukturë (dhoma e përkujdesit, ambulancat), dhe në burime njerëzore si stafi mjekësor dhe psiko-social krijojnë premisa për cenimin e të drejtës për përkujdesje shëndetësore.

KShH i ka rekomanduar DPB-së të shqyrtojë mundësinë e mbylljes së I EVP Tepelenë, për shkak të infrastrukturës shumë të dobët dhe të pamundësisë për të garantuar kushte që respektojnë kujdesin shëndetësor, higjienën dhe dinjitetin njerëzor të shtetasve. I EVP Tepelenë, do të duhej të mbyllej edhe sipas rekomandimeve të mëparshme të KPT-së, që do të thotë se organet përgjegjëse duhet ta trajtojnë me më tepër seriozitet situatën lidhur me këtë institucion.

Sa i përket së drejtës për proces të rregullt ligjor në proceset disiplinore ndaj shtetasve të dënuar/paraburgosur, praktika e ndjekur për ekzekutimin e masave disiplinore, duhet unifikuar nga I EVP-të, pasi përjashtimi nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë si dhe përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë, duhet të zbatohen pasi të jenë ezauruar rrugët e ankimit dhe vendimi të marrë formë të prerë. Sikundër thamë më lart, ky proces merr rëndësi për të drejtën e ankimit dhe për shmangien e pasojave abuzive në zbatim të masave disiplinore në proces ankimi. Gjithashtu, duhen respektuar të gjitha garancitë për prezencën e mjekut në procedimin disiplinor, marrjen e rekomandimit prej tij/saj nëse i dënuari/paraburgosuri e përballon ose jo izolimin nën efektin e masës disiplinore dhe kontrollin e rregullt mjekësor gjatë ekzekutimit të kësaj mase.

Në sistemin penitenciar vijon të ekzistojë problematika e mungesës së stafit mjekësor, ndaj dhe duke mbajtur në konsideratë mungesën e interesit nga mjekët për të kontribuar në shërbimin

mjekësor të sistemit të burgjeve, do duhej që të shtohet vëmendja në zhvillimin e politikave për promovimin në karrierë të stafit ekzistues mjekësor, angazhimin nëpërmjet praktikave profesionale/stazhit të studentëve të mjekësisë, si dhe rishikimin e nivelit të pagave për këtë sektor në raport me shkallën e vështirësisë. KShH rithekson rekomandimin e vazhdueshëm struktural të adresuar ndaj MD-së dhe MSHMS-së, për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e nivelit të shërbimit shëndetësor në burgje.

Gjithashtu, mospasja e rregullores së brendshme nga pjesa dërmuese e IEVP-ve tregon se aktet nënligjore për jetën e brendshme institucionale nuk vlerësohen të rëndësishme prej tyre, duke krijuar vakum kështu për një sërë situatash praktike, për të cilat do ishte i nevojshëm detajimi i mëtejshëm i parashikimeve ligjore.

KShH nisur nga fakti që disa nga rekomandimet janë akoma në proces, dhe mund të konsiderohen si të paplotësuara, vlerëson të ritheksojë për sa vijon:

a. Mbi çështje të të drejtave të individëve të dënuar

IEVP Lushnjë, rekomandohet të vazhdojë marrjen e masave për zhvillimin e kurseve të formimit profesional, një problem i ngritur në vazhdimësi për këtë institucion. Në përgjigje të rekomandimit, IEVP Lushnjë ka njoftuar se Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Dormimit Profesional Publik, ka refuzuar bashkëpunimin për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore. Sidoqoftë nga institucioni kërkesa është ripërsëritur si dhe është vënë në dijeni DPB-ja mbi problematikën. IEVP Lushnjë rekomandohet të vazhdojë përpjekjet për marrjen e masave për vendosjen e një klase të dedikuar për takimet me stafin ligjor dhe psiko-social. Në përgjigje të këtij sugjerimi, IEVP Lushnjë ka njoftuar se po merren masa për përshtatjen e një ambienti që do të shërbejë si klasë psiko-sociale.

IEVP Rrogozhinë, rekomandohet të vazhdojë përpjekjet për përshtatjen e ambienteve ekzistuese dhe pasjen e një ambienti të veçantë për pirjen e duhanit për të ruajtur standardet shëndetësore. Në përgjigje të shkresës së ardhur mbi plotësimet e rekomandimeve, kjo IEVP e ka parë të pamundur realizimin e këtij rekomandimi, duke u shprehur se krijimi i ambienteve të veçanta është i vështirë, duke pasur parasysh infrastrukturën e institucionit. GJEDNJ-ja është shprehur se duhanpirja pasive në vendet e ekzekutimit të vendimeve penale, është problem i të drejtave të njeriut, kur për shtetasit e privuar nga liria ka rekomandim mjeku që për arsye shëndetësore, i burgosuri do duhej ta shmangte edhe duhanpirjen pasive, shteti ka detyrimin të sigurojë ndarjen e qelive.¹⁹

IEVP Shkodër rekomandohet të vazhdojë përpjekjet për marrjen e masave për të garantuar standardet e duhura për përfshirjen konstruktive të të burgosurve në aktivitete sportive. Në përgjigje të rekomandimit, ky institucion thekson se është në komunikim të vazhdueshëm me shoqatat dhe OJQ për krijimin e ambienteve sportive dhe palestrave. KShH vlerëson se adresimi i

¹⁹Vendimi Florea kundër Rumanisë, 22 shtator 2022.

këtij rekomandimi në një institucion të ri të ekzekutimit të vendimeve penale nuk duhet të ngelet në vullnetin apo mundësitë që kanë organizatat për të ofruar mbështetjen e tyre materiale.

IEVP Burrel zbatonte masat disiplinore, pa pritur kalimin e afateve të ankimit, duke cenuar të drejtën e ankimit efektiv. KShH ka vlerësuar se institucioni duhet të respektojë afatet e ankimit dhe marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor ose vendimit të Komisionit të Apelit në rast mosankimi, dhe më pas të vihet në lëvizje për ekzekutim, *të paktën* për dy masat që lidhen me përjashtimin nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë, ose 14 ditë.

IEVP “Jordan Misja” rekomandohet të marrë masa në vazhdimësi për garantimin e së drejtës për të pasur një përkthyes për të gjithë shtetasit e huaj të cilët nuk kanë njohuri të gjuhës shqipe, ashtu sikundër thekson dhe praktika e konsoliduar e GjEDNj-së.²⁰

b. Mbi çështje të tjera institucionale strukturale

- *IEVP-të* e monitoruara ende nuk kanë miratuar rregulloret brendshme. Ky standard lidhet me veprimet pozitive të autoriteteve shtetërore për respektimin e standardeve normativiste të rregulluara përmes akteve nënligjore.
- *IEVP Shkodër, Tepelenë, Fushë –Krujë, Lezhë* kanë mangësi në personel dhe staf të punësuar, si punonjës sigurie, mjekë, psikologë e sociologë, ndaj dhe do duhet që në kordinim dhe bashkëpunim me instiucione të tjera, të merren masa për zhvillimin e politikave të përshtatshme me qëllim rritjen e interesit të profesionistëve të rinj për t’u angazhuar pranë sistemit penitenciar; *IEVP Burrel, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve* duhet të vazhdojë marrjen e masave për shtimin në stafin e punonjësve të policisë, që lidhet dhe me sigurinë në burgje.
- *IEVP Shkodër dhe Peqin*, duhet të vazhdojë trajnimet për personelin e këtij institucioni mbi teknikat që mundësojnë përdorimin minimal të forcës për të ndaluar sjelljet agresive të të dënuarve.
- *IEVP Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve* duhet të fokusohet në rritjen e kapaciteteve të punonjësve përgjegjës për legjislacionin e zbatueshëm për procedimet disiplinore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, përmes trajnimeve dhe metodave të tjera informuese dhe edukuese.

²⁰ Vendimi Vizgirda kundër Sllovenisë.